



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.20, datë 09.01.2020

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ.{...}
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQTAR,
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.01.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjëndjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj.{...}”, përgatitur nga relatori z.Illir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj.{...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është candidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

- a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 01.04.2019, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);
- b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit për Statusin dhe është përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr.11, datë 15.05.2019, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjell pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr.1588 prot., datë 27.05.2019 (protokolluar me nr. 2898 prot., datë 27.05.2019).

2. Me Vendimin nr.83, datë 05.06.2019, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar edhe si Këshilli) ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për kandidatët për magjistratë, profili gjyqtarë, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...} si relator u caktua z. Ilir Toska.

3. Më datë 10.06.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, znj. Alimadhi (më poshtë referuar dhe si kandidatja), në rrugë elektronike, u njoftua : - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidatja depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 14.06.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 25.06.2019 dhe 28.06.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit për Statusin, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjell për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, pas kërimit dhe dhënies nga kandidatja, në rrugë elektronike, të të dhënave të punësimit, më datë 01.07.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet shtetërore dhe private që kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidatës, të cilët kanë përcjell për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 23.09.2019, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 27.09.2019 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose jo të kandidatës {...} për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, sipas nenit 28 të Ligjit për Statusin

12. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, sipas nenit 28 të Ligjit për Statusin, për pranimin në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, përfshirë edhe për kandidaten {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ (“Kandidimi

¹ “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti.

2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit.

3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit për Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 01.04.2019, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit për Statusin. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidatja {...}.

13. Gjithsesi, për kandidaten {...}, u verifikuan sërish disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit për Statusin.

13.1 Për këtë është mbajtur në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2019), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (1 Prill 2019), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidates për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, e cila ka rezultuar fituese në provimin e pranimit. Dhe po ashtu, nga ana tjetër, është mbajtur në konsideratë edhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike në kohën e kandidimit, si dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

13.2 Gjithashtu, për këtë është mbajtur në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”)², pika 4,

4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij.

5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe aktet nënligjore përkatëse”.

² 1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ

shkronja “c”, të Ligjit për Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkaku përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, është mbajtur në konsideratë se detyrimi i Këshillit për verifikimin e kritereve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit për Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit për Statusin.

14. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikua sërish kriteri:

a) i pasjes së zotësisë së plotë për të vepruar. Për këtë kriter nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin, me vendim gjyqësor të formës së prerë, të zotësisë për të vepruar të kandidatës;

disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. *Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshem të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.*

4. *Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur:*

a) *raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asetë ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të asetëve;*

b) *raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";*

c) *ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.*

5. *Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.*

6. *Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij.*

7. *Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.*

b) i pasjes së shtetësisë shqiptare. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti “Pasaportë”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 10.05.2011, ku pasqyrohet përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen kandidates të shtetësisë shqiptare. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 01.10.2019, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) i gjendjes gjyqësore. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin gjyqësor elektronik të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 28.02.2019. Ndërkohë, gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidates, u administrua Shkresa nr.V-2125/1 prot., datë 04.07.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidatja nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) i disiplinës në punë. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës nga kandidatja është depozituar Vërtetim datë 25.02.2019, i Departamentit të Administratës Publike dhe Vërtetim datë 25.03.2019, i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Ndërkohë, gjatë verifikimit, u administruan Shkresa nr.999/1 prot., datë 03.07.2019, e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Shkresa nr.688/1 prot., datë 04.07.2019, e Institutit të Sigurisë Ushqimore, Shkresa nr. k-1846/1 prot., datë 09.07.2019, e Ujësjetillës Kanalizimeve Tiranë (UKT) sh.a., Shkresa nr.3966/1 prot., datë 10.07.2019, e Departamentit të Administratës Publike (Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil), Shkresa nr.2887/1 prot., datë 18.07.2019, e Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., Shkresa nr.899 prot., datë 29.07.2019, e Qendrës së Furnizimit Materialo-Teknik, Shkresa nr.14231/1 prot., datë 31.07.2019, e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Shkresa nr.6385/2 prot., datë 07.08.2019, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve). Sipas këtyre dokumenteve kandidatja nuk është e larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ajo nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) i qenies bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete. Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidates bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

15. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të cilat janë verifikuar nga kjo e fundit si organi kompetent, u konsiderua vlerësimi i bërë prej saj dhe konkretisht për:

a) *pasjen e kriterit arsimor.* Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentet “Diplomë”, me nr. 7534, datë 05.07.2002, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Certifikatë Notash datë 10.07.2002, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

b) *pasjen e përvojës profesionale.* Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “Librezë Punë”, sipas të cilit kandidatja ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë në administratën publike, në sektorin shtetëror (ndërmarrje shtetërore, shoqëri tregtare shtetërore), etj. Konkretisht, kandidatja znj. Alimadhi del të ketë punuar si: - “jurist i prokurimeve” pranë Qendrës së Furnizimit Materialo Teknik, për periudhën 01.12.2002-30.01.2006; - “teknik, specialist, ekspert” pranë Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a, për periudhën 01.02.2006-31.12.2007; - “Drejtor i Departamentit Juridik” pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., më pas nën emrin CEZ Shpërndarje sh.a. (sot Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.), për periudhën 01.01.2008-10.04.2013; “Drejtor i komanduar i Departamentit të Administrimit të Përgjithshëm” pranë ish-CEZ Shpërndarje sh.a. (sot Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.), për periudhën 10.04.2013-30.09.2013; - “Këshilltar në Kabinetin e Ministrit” dhe “Drejtor i Drejtorisë Juridike” pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), për periudhën 20.09.2013-09.10.2017; - “Sekretar i Përgjithshëm” pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për periudhën 09.10. 2017-23.01.2019; - “Zëvendësdrejtor Ekzekutiv dhe Drejtor i Departamentit të Zhvillimit Rajonal” pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, për periudhën Shkurt 2019 e në vijim;

c) *mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit.* Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk është anëtare e ndonjë partie politike;

ç) *mosqenien anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990.* Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990 (kandidatja është e datëlindjes 27.12.1979).

B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 32 të Ligjit për Statusin

16. Për kandidaten {...} u verifikua edhe kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin.

17. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 40/27 prot., datë 19.08.2019.

18. Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë dhe interesave.

19. Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...}, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

20. Për konkluzionet se deklarimi i kandidates {...} nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe se ajo ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë, ILDKPKI-ja ka konsideruar konstatimin nga kontrolli për *“Mospërputhje e të ardhurave të b/shortit nga shoqëria “Dola” sh.p.k dhe konfirmimit nga ISSH për periudhën 2005-2011, të ardhura të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të ndërtuar po nga kjo shoqëri, rrjedhimisht mungesë dokumentacioni për këto të ardhura. Kandidatja/subjekti është martuar në vitin 2015”*.

20.1 Në lidhje me këtë konstatim, referuar pjesës përshkruese të Raportit, rezulton se ILDKPKI-ja ka konsideruar këto fakte:

- a) Lidhja e Kontratës së Porosisë nr.707 rep. dhe nr. 114 kol., datë 18.03.2011, nga bashkëshorti i kandidates, z.Taulant Qypi, me subjektin ndërtues “Erdo Construction” (me Nipt K82208022G), me ortake të vetme dhe administratore znj.Luljeta Kasi (Nurka), përfaqësuar me prokurë nga Bujar Nurka, kontratë sipas të cilës z.Qypi ka porositur një apartament banimi (nr.5) të papërfunduar, me sipërfaqe totale (përfshirë dhe ambientet e përbashkëta) prej 65 m², me vendndodhje Komuna Kashar, kundrejt çmimit 25.350 euro, çmim ky që sipas kontratës do të paguhej në tre këste, konkretisht kësti i parë (15.570 euro) në momentin e nënshkrimit të kontratës, kësti i dytë (8.780 euro) në momentin e ndërtimit të karabinasë dhe kësti i tretë (1.000 euro) në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes;
- b) Pagimi nga z.Qypi të çmimit kontraktor si më lart gjatë periudhës 2011-2013, bazuar kjo në mandat-arkëtimet e Shoqërisë “Erdo Construction”, të paraqitura nga kandidatja bashkëlidhur deklaratës së pasurisë, konkretisht: Mandat-Arkëtimin nr.46, datë 17.03.2011, për shumën 15.570 euro; Mandat-Arkëtimin nr.50, datë 07.07.2011, për shumën 2.837 euro; Mandat-Arkëtimin nr.58, datë 14.11.2011, për shumën 2.860 euro; Mandat-Arkëtimin nr.64,

datë 06.04.2012, për shumën 3.430 euro; Mandat-Arkëtimin nr.71, datë 02.04.2013, për shumën 653 euro, në total 25.350 euro;

- c) Lidhja e Kontratë Cedimi (transferimi) Pronësie nr.3069 rep. dhe nr.1989 kol., datë 25.10.2017, me palë e parë shitëse (porositëse) Taulant Qypi, palë e dytë blerëse Shqiponja Mete dhe palë e tretë (e porositur) Shoqëria “Erdo Construction” sh.p.k, sipas të cilës pala e parë Taulant Qypi i kalonte të gjithë të drejtat dhe detyrimet e Kontratës së Porosisë nr.707 rep. dhe nr. 114 kol., datë 18.03.2011, palës së dytë Shqiponja Mete, ndërsa të gjitha palët kontraktore binin dakort që pasuria objekt kontrate të blihej nga pala e dytë Shqiponja Mete për çmimin 23.000 euro, shumë e cila do të likujdohej në favor të palës së parë, në rrugë bankare, brenda datës 26.10.2017;
- ç) Pagimi nga znj.Mete të çmimit kontraktor, shumës 23.000 euro, me transfertë bankare, më datë 26.10.2017, në Intesa SanPaolo Bank, në favor të z.Qypi, ku gjendja e llogarisë së këtij të fundit në këtë bankë, më datë 02.07.2019, ka qenë 12.708 euro.

20.2 Po ashtu, në lidhje me konstatimin si më lart, referuar pjesës përshkruese të Raportit, rezulton se ILDKPKI-ja ka konsideruar edhe këto fakte:

- a) Deklarimi i bërë nga bashkëshorti i kandidates, z.Qypi, në deklaratën e pasurisë, në cilësinë e personit të lidhur, në lidhje me pasurinë e luajtshme, likujditete në shumën 12.708 euro, gjendje në llogari kursimi pranë Intesa SanPaolo Bank, zotëruar 100% prej tij, për të cilën ka shpjeguar se:

“Kjo llogari është krijuar si rezultat i cedimit/transferimit (shitjes) së të drejtave mbi një apartament tek një palë e tretë në vlerën 23.000 Euro sipas kontratës noteriale nr.rep.3069 dhe nr.kol.1989 datë 25.10.2017 (statement bashkëlidhur). Nga kjo llogari janë kryer dy tërheqje nga të cilat 6.000 Euro janë përdorur për mobilim, ndërsa pjesa tjetër për nevoja të ndryshme të miat. Burimi i krijimit:

Në bazë të Kontratës noteriale nr. rep. 3069 dhe nr. kol. 1989, datë 25.10.2017 është bërë cedimi/transferimi i të drejtave mbi apartamentin e banimit nr. 5 të papërfunduar, me vendodhje në Kashar, në sipërfaqe totale (përfshirë edhe hapësirën e përbashkët) 65 m², i porositur në bazë të Kontratës së Porosisë nr. 797 rep. dhe nr. 114 kol, datë 18.03.2011. Vlera e cedimit/transferimit të këtij apartamenti ishte 23.000 Euro. Kjo vlerë është transferuar në llogarinë time pranë Bankës Intesa Sanpaolo nga ana e palës së dytë (blerësi) znj. Shqiponja Barjam Meta. Kontrata e cedimit/transferimit është konfirmuar edhe nga pala sipërmarrëse tek e cila e kisha porositur këtë apartament. Sqaroj se ky apartament ishte porositur nga ana ime në mars 2011 (disa vite përpara lidhjes së martesës) mbi bazën e Kontratës së Porosisë nr. 797 rep. dhe nr. 114 kol. datë 18.03.2011, për vlerën 25.350 euro. Sqaroj se burimi i të ardhurave për porositjen e këtij apartamenti, kanë qenë disa kursime dhe kryesisht pagat e mia të prapambetura pranë punëdhënësit, shoqëria Dola sh.p.k me Nipt K74517807V, ku kam qenë i punësuar në periudhën Maj 2005 deri në Janar 2011 (Vërtetimi i pagës bashkëlidhur). Sqaroj se gjatë viteve të fundit të punësimit, shoqëria ishte

në pozitë të vështirë financiare dhe për këtë arsye kishte një vlerë të konsiderueshme pagash të prapambetura pa u ekzekutuar. Referuar mandat pagesës me nr. 57, datë 17.03.2011 për vlerën 2.180.000 lekë, mandat pagese 165, datë 07.07.2011 në vlerën 400.000 lekë, mandat pagese nr. 273, datë 14.11.2011 në vlerën 400.000 lekë, mandat pagese nr. 56, datë 06.04.2012 me vlerën 480.000 lekë, rezulton se janë ekzekutuar paga të prapambetura nga ana e punëdhënësit, shoqëria Dola sh.p.k. Pikërisht këto pagesa kanë shërbyer edhe për ekzekutimin e detyrimit të Kontratës së Porosisë nr. 797 rep. dhe nr. 114 kol, datë 18.03.2011. Disa detaje mbi këtë proces i gjeni në rubrikën e të dhënave konfidenciale. Zotëroj 100%”;

- b) Punësimi i bashkëshortit të kandidates, z.Qypi, prej Shkurtit 2001, si inxhinier ndërtimi, në disa shoqëri ndërtimi, ndër të cilat, në veçanti, në Shoqërinë “Dola” sh.p.k (me Nipt J74517807V), me ortak dhe administrator z.Bujar Nurka;
- c) Pagat e deklaruara për bashkëshortin e kandidates, z.Qypi, mbi të cilat janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale, për disa subjekte private, ndër të cilat, në veçanti, edhe Shoqëria “Dola” sh.p.k, për të cilën, nga konfirmimet e marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ka rezultuar pagimi i këtyre kontributeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale për periudhën Maj 2005 - Dhjetor 2007, për totalin e pagave mbi të cilat është derdhur kontribut në shumën 587.618 lekë, ku për periudhën Shtator 2005 - Shkurt 2007, paga mbi të cilën është derdhur kontribut ka qenë 14.000 lekë, ndërsa për periudhën Qershor - Dhjetor 2007, kjo page ka qenë 40.000 lekë, ndërkohë që për periudhën Maj 2008 - Mars 2011, emri i bashkëshortit të kandidates nuk figuron në listëpagesat e kësaj shoqërie.

20.3 Sipas Raportit të ILDKPKI-së, në analizë të fakteve si më lart, është konstatuar:

“Mospërputhje e të ardhurave të b/shortit nga shoqëria “Dola” shpk dhe konfirmimit nga ISSH për periudhën 2005 - 2011, të ardhura të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, të ndërtuar po nga kjo shoqëri, rrjedhimisht mungesë dokumentacioni për këto të ardhura. Kandidatja/subjekti është martuar në vitin 2015.

- *Të ardhurat nga paga në shoqërinë “Dola” shpk nuk konfirmohen nga dokumentacioni i paraqitur nga ISSH dhe DRT për periudhën 2005 - 2011.*
- *Sipas shkresës së shoqërisë, bashkëshorti është paguar me 100.000 lekë/muaj dhe 150.000 lekë/muaj, ndërsa sipas dokumentacionit të paraqitur nga ISSH paga rezulton 14.000 lekë dhe 40.000 lekë.*
- *Të ardhurat nga shoqëria “Dola” shpk sipas mandate pagesave paraqitur, të cilat janë përdorur për blerjen e apartamentit në Kashar, rreth 3.892.000 lekë.*
- *Është e paqartë nëse mbi këto të ardhura janë shlyer detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa.*
- *Të ardhurat e dokumentuara të b/shortit janë rreth 16.535.000 lekë”.*

21. Më datë 28.08.2019, bazuar në Vendimin 75/2019 (Kreu IX, Seksioni A, pika 11, shkronja “b”), në adresën elektronike, kandidates iu dërgua Raporti i Kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë përgatitur nga ILDKPKI-ja, duke u ftuar ajo për të paraqitur shpjegime dhe dokumente mbështetës në lidhje me përfundimet e këtij raporti.

22. Mbi kërkesë të kandidates, bazuar në Kreun IX, Seksioni A, pika 11, shkronja “b”, të Vendimit 75/2019, afati i paraqitjes së shpjegimeve dhe dokumenteve mbështetës nga ana e kandidates u zgjat nga relatori deri më datë 06.09.2019.

23. Brenda afatit të caktuar kandidatja depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor shpjegimet me shkrim dhe dokumente mbështetës në lidhje me Raportin e Kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private.

24. Bazuar në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin 75/2019 (Kreu IX, Seksioni A, pika 11, shkronja “a”), me Shkresën nr.3281/6 prot., datë 06.09.2019, shpjegimet me shkrim dhe dokumentet mbështetës të paraqitura nga kandidatja iu dërguan ILDKPKI-së, duke iu kërkuar asaj trajtimi i tyre brenda kuadrit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kësaj kandidate, si dhe, mbi këtë bazë, dërgimin e informacionit shtesë.

25. Mbi këtë kërkesë, pas trajtimit të shpjegimeve dhe dokumenteve mbështetës të paraqitura nga kandidatja, ILDKPKI-ja dërgoi Raportin Shtesë nr. 40/28 prot., datë 23.09.2019.

26. Edhe sipas Raportit Shtesë, ILDKPKI-ja ka konkluduar se për kandidaten {...}:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar të ardhurat e deklaruara nga b/shorti;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

27. Në Raportin Shtesë, ndryshe nga Raporti Fillestar, konkludohet se për kandidaten ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti i saj.

28. Edhe në këtë rast, konkluzionet se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe se për kandidaten ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti i saj, është rezultat i të njëjtit konstatim nga ILDKPKI-ja, pra të mospërputhjes së të ardhurave të deklaruara nga bashkëshorti i kandidates si të fituara nga paga prej Shoqërisë “Dola” sh.p.k dhe konfirmimit të marrë për këto të ardhura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për

periudhën 2005 -2011, të ardhura këto që kanë shërbyer si burim për blerjen, në vitin 2011, të apartamentit, në gjendje karabina, me vendndodhje në Kashar, me vlerë 25.350 euro, çka rrjedhimisht çonte në konkluzionin për mungesë dokumentacioni justifikues për këto të ardhura. Konkretisht, ILDKPKI-ja ka arsyetuar se:

“... referuar edhe sqarimeve e dokumentacionit shtesë të paraqitur nga kandidati, lidhur me të ardhurat e b/shortit nga shoqëria “Dola” shpk, për periudhën 2005-2011, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen në vitin 2011 të apartamentit në Kashar, në vlerën 25,350 Euro, kontatohet si vijon:

Kandidati nuk ka paraqitur dokumentacion shtesë lidhur me shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit për të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “Dola” shpk, por shprehet se do ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim me shoqërinë, në rast të kundërt do të drejtohet në organet kompetente. Dokumentacioni dhe sqarimet e dhëna, vetëm provojnë punësimin e tij në këtë shoqëri.

Sipas sqarimeve të dhëna është konstatuar mospagimi i tatimit mbi pagën, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësi “Dola”, por sipas vërtetimit që kjo shoqëri ka lëshuar më datë 15.10.2018 (paraqitur nga kandidati/subjekti), Taulant Qypi për periudhën maj-dhjetor 2005 ka marrë pagën neto 100,000 lekë, janar- dhjetor 2006 pagë neto 120,000 lekë, janar 2007- janar 2011 pagë neto 150,000 lekë.

Të ardhurat nga pagat në shoqërinë “Dola” shpk të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Kashar, me vlerë 25,350 Euro, nuk konfirmohen nga ISSH dhe DRT për periudhën maj 2005-2011, sipas shkresës së shoqërisë, bashkëshorti është paguar me 100.000 lekë/muaj dhe 150.000 lekë, ndërsa sipas ISSH paga rezulton 14,000 lekë dhe 40,000 lekë vetëm për periudhën maj 2005; shtator 2005-dhjetor 2007. Totali i pagave bruto mbi të cilën është derdhur kontributi 587,618 lekë.

Të ardhurat e mësipërme nga shoqëria “Dola” shpk janë krijuar para lidhjes së martesës së kandidatës me bashkëshortin, por nga ana tjetër, pasuri aktuale e bashkëshortit, është depozita prej 12,708 Euro e krijuar nga cedimi/transferimi i të drejtave të apartamentit me vlerë 25,350 Euro, me burim të ardhurat nga shoqëria “Dola” shpk”

29. Pra, sipas Raportit Shtesë të ILDKPKI-së, nga kontrolli pasuror i kandidatës dhe bashkëshortit si person i lidhur, rezulton:

- i) deklarim jo i saktë nga bashkëshorti i kandidatës i të ardhurave nga pagat në Shoqërinë “Dola” sh.p.k, për periudhën 2005-2011;
- ii) mungesë dokumentacioni ligjor për justifikimin e pasurisë së bashkëshortit të kandidatës, shumës 12.708 euro gjendje në llogari bankare kursimi.

30. Më datë 04.10.2019, në adresën elektronike, kandidatës iu dërgua Raporti Shtesë i Kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë përparitur nga ILDKPKI-ja, duke u ftuar ajo përsëri për të paraqitur shpjegime dhe dokumente mbështetës në lidhje me përfundimet e këtij raporti.

31. Brenda afatit të caktuar, më datë 07.10.2019, kandidatja dërgoi, në rrugë elektronike, shpjegimet e saj në lidhje me Raportin Shtesë të Kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private, duke pretenduar se konkluzionet e ILDKPKI-së janë të pasakta dhe të nxjerra në interpretim të gabuar të ligjit, ndërsa deklarimi ishte i saktë e në përputhje me ligjin dhe se për pasurinë e bashkëshortit, depozitën bankare prej 12.708 euro, kishte paraqitur dokumentacion ligjor justifikues.

32. Në shpjegimet e saj, kandidatja ka parashtruar tre kundërshtime kryesore, si më poshtë vijon:

32.1 Kundërshtimi i parë:

(i) Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 9062, datë 08.05.2003, “Kodi i Familjes”, pasuria e luajtshme në formën e likuiditeteve në vlerën 12.708 euro, disponuar 100% nga bashkëshorti dhe të ardhurat nga puna e tij pranë Shoqërisë “Dola” sh.p.k, për periudhën Maj 2005-Janar 2011, që kanë shërbyer për blerjen, në vitin 2011, të apartamentit të papërfunduar në Kashar, nga transferimi i të drejtave mbi të cilit është siguruar kjo depozitë, nuk bën pjesë në pasurinë e përbashkët bashkëshortore. Kjo depozitë, e krijuar dhe që posedohet nga bashkëshorti, përfaqëson pasuri vetjake të tij, që është krijuar nga tjetërsimi i po një pasurie të mëparshme vetjake të tij;

(ii) Për apartamentin e papërfunduar në Kashar, sipas dokumentacionit të depozituar, është lidhur nga bashkëshorti Kontrata e Porosisë datë 18.03.2011, ndërsa ekzekutimi i detyrimit nga ai sipas kësaj kontrate është bërë me disa këste, konkretisht gjatë vitit 2011 është shlyer vlera 21.267 euro, gjatë vitit 2012 vlera 3.430 euro dhe gjatë vitit 2013 edhe pjesa e mbetur në vlerën 653 euro;

(iii) Porositja dhe likuidimi i çmimit kontraktor për këtë apartament është bërë nga bashkëshorti përpara martesës së tyre, e cila është lidhur më datë 25.02.2014, sipas çertifikatës së martesës së depozituar, kohë kur ka nisur dhe bashkëjetesa e tyre pranë shtëpisë së prindërve të bashkëshortit;

(iv) Edhe pse në këtë rast kontrolli i deklaratës së pasurisë dhe interesave private nuk është në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, vlen të mbahet në konsideratë qëndrimi i organeve të rivlerësimit, konkretisht Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), i cili, në situatë deri diku të ngjashme përsa i përket pasurive që sigurohen përpara martesë dhe që disponohen veçmas nga personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit (Vendimi nr.181, datë 18.07.2019), ka konkluduar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe, në këtë kuptim, nuk e ka konsideruar si shkak, për të dalë me konkluzion negativ, faktin se personi i lidhur me subjektin

e rivlerësimit nuk provonte apo nuk kishte burime financiare për blerjen e një pasurie të krijuar nga personi i lidhur përpara martesës me subjektin e rivlerësimit;

(v) marrëdhënia juridike e punësimit ndërmjet bashkëshortit të saj dhe punëdhënësit Shoqëria “Dola” sh.p.k, në bazë të të cilës bashkëshorti ka siguruar të ardhurat që në finale kanë shërbyer si burimi i krijimit të depozitës bankare në zotërimin vetëm të tij, është zbatuar para martesës dhe njohjes së tyre, çka për të cilën ajo nuk ka pasur asnjë mundësi që në bazë të njohurive të saja si juriste, të ushtronte kujdesin e nevojshëm për të identifikuar dhe për të marrë masa për ta shmangur këtë situatë, pra atë të mospagimit të tatimit mbi të ardhurat nga pagat, me të cilën kanë rënë në dijeni vetëm në Korrik 2019, ndërkohë që përgjegjësinë ligjore për këtë situatë e kishte tërësisht punëdhënësi i bashkëshortit.

32.2 Kundërshtimi i dytë:

(i) Të ardhurat e bashkëshortit që kanë shërbyer për blerjen, në vitin 2011, të apartamentit të papërfunduar, me vendndodhje në Kashar, për vlerën 25.350 euro, të drejtat mbi të cilin më pas, në vitin 2017, janë ceduar kundrejt vlerës 23.000 euro, nga e cila është krijuar pasuria 12.708 euro gjendje në depozitë bankare në zotërim të bashkëshortit, janë të ardhura të ligjshme pasi janë fituar nga puna e bashkëshortit si inxhinier ndërtimi pranë Shoqërisë “Dola” sh.p.k, për periudhën Maj 2005-Janar 2011;

(ii) Mbështetur në parashikimet e ligjit të kohës gjatë së cilës është shtrirë marrëdhënia e punës së bashkëshortit pranë Shoqërisë “Dola” sh.p.k, konkretisht neneve 117 dhe 121 të Kodit të Punës, nenit 13 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neneve 6 dhe 8 të Ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, nenit 10, paragrafi 2, të Ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 8 dhe 10 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe paragrafëve 2.6.1 dhe 2.6.2 të Udhëzimit nr.5, datë 30.1.2006, të Ministrisë të Financave, “Për tatimin mbi të ardhurat”, është punëdhënësi ai që ka detyrimin për deklarimin, evidentimin, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve, si për tatimin mbi të ardhurat personale, ashtu dhe të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore. Në këtë kuptim, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore bashkëshorti i saj si punëmarrës për mospërmbushje të detyrimeve nga ana e punëdhënësit të tij dhe, për pasojë, të ardhurat e tij nga paga të mos konsiderohen si të ligjshme;

(iii) Edhe pse në këtë rast kontrolli i deklaratës së pasurisë dhe interesave private nuk është në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, vlen të mbahet në konsideratë qëndrimi i organeve të rivlerësimit, konkretisht Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), i cili, në një situatë deri diku të ngjashme përsa i përket të ardhurave nga puna për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore (Vendimi nr.103,

datë 05.02.2019), ka konkluduar se: “...omissis...40. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave konstatohet se shtetasi ... vërtetoi në mënyrë të pakontestueshme se marrëdhënia e tij e punësimit është e ligjshme dhe të ardhurat e përfituara kanë qenë nga një marrëdhënie pune e ligjshme. Mospagimi i taksave për një pjesë të të ardhurave në shumën totale prej ... lekë ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe se ato nuk mund të paguheshin nga vetë subjekti. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm faktin se nuk ka pasur dijeni për këtë praktikë të punëdhënësit dhe se bashkëshorti i saj nuk ka bashkëpunuar me punëdhënësin për të shmangur pagimin e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, porse ai ka qenë i dëmtuar nga ky proces. 41. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mospagesat e detyrimeve përkatëse, dhe si rezultat, të ardhurat nga paga të marra ndër vite, do të merren në konsideratë në përlllogaritjen e mjeteve financiare të disponueshme në familjen e tij”;

(iv) Pagat mujore të përfituara periodikisht nga bashkëshorti, ose në periudha të caktuara kohore, kanë qenë gjithmonë paga neto (siç deklarohet edhe në vërtetimin dhe deklaratën noteriale të lëshuar nga punëdhënësi Shoqëria “Dola” sh.p.k), duke krijuar në këtë mënyrë bindjen për të (bashkëshortin) se prej punëdhënësit përmbusheshin tërësisht detyrimet ligjore. Bashkëshorti, gjatë zbatimit të kësaj marrëdhënie juridike pune, në bazë të parimit të mirëbesimit, ka konsideruar se punëdhënësi ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore lidhur me deklarin, evidentimin dhe më tej mbajtjen dhe derdhjen çdo muaj të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Pasi kemi marrë dijeni për këtë fakt, bashkëshorti do të përpiqet që bazuar në legjislacionin në fuqi, të zgjidhë me mirëkuptim këtë konflikt me Shoqërinë “Dola” sh.p.k, në të kundërt do të ndër marrë hapat e duhur ligjor për të kërkuar përmbushjen e të drejtave që i kanë buruar nga kjo marrëdhënie punësimi;

(v) Në trajtimin dhe vlerësimin e kësaj situatë duhet të merret në konsideratë dhe të vlerësohet me objektivitet situata e informalitetit që ka ekzistuar në Shqipëri gjatë periudhës 2000-2010, veçanërisht në sektorin e ndërtimit. Sikundër mund të konstatohet, edhe institucionet shtetërore nuk kanë përmbushur përgjegjësitë e tyre, duke lejuar që kjo situatë, sidomos me deklarin dhe sigurimin e punëmarrësve, të degradojë. Përveç penalizimit dhe dëmit të krijuar bashkëshortit si rezultat i mosdeklarimit apo deklarimi me pagë të ulët në sigurime, gjë që privon nga shumë të drejta, dhe nga ajo më e rëndësishmja që ka të bëjë me vitet e pensionit, tashmë përballat edhe me një vlerësim të tillë subjektiv që vë në dyshim burimin e asaj pasurie të krijuar me djersë dhe punë të ndershme. Gjatë asaj periudhe kohore, më tepër sesa ruajtja, dokumentimi i marrëdhënies së punës, qëllimi i bashkëshortit, si dhe i gjithë qytetarëve të ndershëm, ka qenë punësimi dhe krijimi i të ardhurave në mënyrë që të përballohej jetesa e përditshme duke ndihmuar edhe familjen. Të ardhurat e bashkëshortit janë vetëm fryt i marrëdhënies së punës dhe në vlerësimin tim, dhe të çdo njeriu të arsyeshëm, nuk është e arsyeshme dhe e bazuar që të konkludosh se të ardhurat nga marrëdhënia e punës nuk janë nga

një burim i ligjshëm vetëm sepse punëdhënësi nuk ka kryer deklaratimet në sigurime, dhe që qartësisht ligji e parashikon si detyrim të punëdhënësit dhe vetëm të punëdhënësit;

(vi) Deklarimi është i saktë pasi me përgjegjësi të madhe dhe transparencë janë deklaruar të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit, duke mos u përpjekur për të fshehur ose për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë. Përderisa marrëdhëniet e punës dhe të ardhurat nga paga të bashkëshortit me Shoqërinë “Dola” sh.p.k provohen me dokumentacionin e paraqitur, vërtetime, deklarata noteriale, mandate pagesa, fatura tatimore/situacione, kontrata furnizimi, nuk ka asnjë bazë të pretendohet se deklarimi nuk është i saktë. Është e paqartë se cili deklarim do të ishte i saktë në këtë rast, pasi mosdeklarimi i të ardhurave reale të bashkëshortit dhe deklarimi i tyre në nivelin që rezultojnë në ISSH, do të çonte para rastit të deklarimit të rremë.

32.3 Kundërshtimi i tretë:

(i) Për standardet e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë ILDKPKI-ja nuk i është referuar parashikimeve të nenit 32 të Ligjit për Statusin, por Nenit D, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklarimin dhe standardet/kushtet dhe prezumimet që aplikohen gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve sipas nenit 179/b të Kushtetutës, ku nuk përfshihen kandidatët për në formimin fillestar për magistratë në Shkollën e Magjistraturës;

(ii) Parashikimet kushtetuese përsa i përket procesit të rivlerësimit kalimtar, janë përcaktime të jashtëzakonshme, të ndërmarra në kuadër të një qëllimi të madh që është pikërisht rikthimi i besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, pikërisht tek trupa e gjyqtarëve dhe prokurorëve meqënëse besimi tek sistemi ka rënë si rezultat i perceptimit të publikut të ekzistencës së një sistemi që vuan nga korrupsioni. Pikërisht për këtë, procesi i rivlerësimit ka pasur si synim të evidentonte shkeljet profesionale apo pasuritë e paligjshme që janë siguruar si rezultat i shfrytëzimit të pozicionit të prokurorit dhe gjyqtarit, si përfshirja në raste korrupsioni, ushtrimi i paligjshëm i ndikimit etj, raste nga të cilat janë siguruar përfitime pasurore të paligjshme;

(iii) Ligjvënësi nuk aplikojnë të njëjtat parashikime mbi procesin e kontrollit të pasurisë për të gjithë subjektet e tjerë, të ndryshëm nga ata që janë subjekt i procesit të rivlerësimit, të cilët janë subjekt deklarimi në kuptim të parashikimit të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Konkretisht, në bazë të nenit 3/1 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, pika 1, shkronja c, kandidatët për magistratë, janë një prej kategorive që mbartin detyrim për deklarim dhe për të cilët ILDKPKI kryen kontrollin e plotë të pasurisë. Prezumimet e parashikuara në nenin D të Kushtetutës përsa i përket konceptit të pasurisë që tejkalon dyfishin e pasurisë së ligjshme, apo konceptit të pasurisë së ligjshme për të cilën janë paguar detyrimet fiskale, janë prezumime që aplikohen gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nëse këto prezumime do të ishin të aplikueshëm për të gjithë kandidatët subjekt deklarimi, atëherë ILDKPKI-ja me të njëjtin standard duhet të vlerësonte dhe të konkludonte për të gjithë zyrtarët subjekt deklarimi.

33. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

33.1 Në informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dërguar me Shkresën nr. 12592/1 prot., datë 08.07.2019, për kandidaten {...} nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.

33.2 Në informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave, dërguar me Shkresën nr. 16911/1 prot., datë 12.07.2019, për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

34. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'i kërkuar ILDKPKI-së bërjen e një kontrolli shtesë.

35. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten znj. {...}, janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se nuk vërtetohen rrethana që të përbëjnë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi për në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës.

36. Fillimisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të evidentojë se në konsideratë të të dhënave të përshkruara në Raportin Final të ILDKPKI-së (Raportin Shtesë), të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, por edhe nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe privatë, dokumentacion ky që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe nga analiza financiare e bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, konstatohet se Raporti është i plotë, i detajuar dhe i qartë, duke mos paraqitur ndonjë mangësi.

37. Referuar të dhënave të rezultuara gjatë procesit të verifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në rastin e kandidates nuk vërtetohet që deklarimi nga ajo i pasurisë dhe aseteve të saj të jetë i rremë ose i pasaktë, që ajo të mos ketë burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e saj, apo që ajo të mos ketë deklaruar pasuri ose asete të saj, rrethana këto që përbëjnë pengesë për pranimin e kandidates në Shkollën e Magjistraturës, referuar nenit 32, pika 4, shkronja "a", të Ligjit të Statusit, sipas të cilit "*Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; ...*".

38. Problematika e vetme, që është evidentuar edhe nga ILDKPKI-ja, në lidhje me deklaratën e pasurisë së kandidates, në fakt ka të bëjë vetëm me saktësinë e të ardhurave, për një periudhë para martese (Maj 2005 - Janar 2011), të deklaruara nga bashkëshorti i saj, si dhe justifikueshmërinë e një pasurie të luajtshme, që aktualisht ekziston në formë likujditeti gjendje në depozitë bankare, në pronësi dhe zotërim të bashkëshortit të saj, me origjinë krijimi nga të ardhurat e tij para martese, pikërisht të periudhës Maj 2005 - Janar 2011.

39. Në lidhje me këtë problematikë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson pjesërisht të bazuara kundërshtimet e kandidates të parashtruara më lart, në pikën 32, të këtij vendimi.

40. Konkretisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuar kundërshtimin e kandidates për mosaplikimin në rastin e kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës të standardit kushtetues të ligjshmërisë së të ardhurave, parashikuar në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni D, pika 3, sipas të cilit: “... *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj*”.

40.1 Këshilli vlerëson se referuar pikës 1, neni Ç, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e pasurisë kryhet nga organet e rivlerësimit, në përputhje me përcaktimet e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Çdo pasuri që është objekt deklarimi i nënshtrohet kontrollit të plotë të vërtetësisë, saktësisë së deklarimit dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit, pa bërë ndonjë dallim apo kufizim në lidhje me kohën e krijimit.

40.2 Në një interpretim të dispozitave të zbatueshme për rivlerësimin e pasurisë të magjistratëve në detyrë, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në pikën 1, neni 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, neni 1, të Ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet kontrollit të pasurisë së tyre synohet identifikimi i atyre subjekteve të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive të krijuara në mënyrë të paligjshme, referuar standardit të përcaktuar në pikën 3, neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Konfirmimi i një rrethane të tillë, qoftë në formën e veprimeve të magjistratit në kundërshtim me ligjin, apo edhe në formën e pranimit të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të magjistratit dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së tij, dhe si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë, duke përbërë shkak për shkarkimin e tij nga detyra.

40.3 Standardi kushtetues i vendosur përmes parashikimit të procesit të rivlerësimit kalimtar për magjistratët në detyrë, që përfshin edhe kontrollin e pasurisë (të krijuar para dhe pas emërimit në detyrën e magjistratit), referuar dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore, është i njëjtë edhe për kandidatët për në formimin fillestar për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës, për kandidatët

për magjistratë (të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës), si dhe për kandidatët për ngritjen në detyrë.

40.4 Konkretisht, neni 136/a përcakton se: *“1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. 2. Kriteria të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”*. Ndërkohë, në Ligjin për Statusin, verifikimi paraprak i pasurisë dhe i figurës parashikohet si kërkesë jo vetëm përpara emërimit të kandidatëve për magjistratë, por edhe përpara pranimit të tyre në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës. Sipas nenit 32 të Ligjit për Statusin, *“1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës. 2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”*.

40.5 Pra, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi nuk bën asnjë diferencim, përkundrazi parashikojnë trajtim të njëjtë të magjistratëve, qoftë të atyre në detyrë në momentin hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese me Ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ashtu dhe të atyre që rekrutohen pas këtij momenti. Standardi i kontrollit të pasurisë, krijuar para ose gjatë ushtrimit të detyrës së magjistratit, është një standard kushtetues qëllimi i të cilit është i qartë, garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë, çka, nga njëra anë, nënkupton largimin nga detyra të magjistratëve në detyrë që nuk kalojnë, ndër të tjera, kontrollin e pasurisë, ndërsa, nga ana tjetër, ndalimin, për të njëjtin shkak, të rekrutimit të magjistratëve të rinj. Për më tepër,

Kushtetuta dhe ligji nuk bëjnë asnjë diferencim për pasurinë e magistratëve në detyrë, duke iu nënshtruar ata kontrollit për çdo pasuri, pavarësisht kohës së krijimit të saj, para ose gjatë ushtrimit të detyrës, ndërkohë që mbi të njëjtin standard ato kërkojnë kontrollin pasuror nga Këshillat të magistratëve të rekrutuar rishtazi, pra të pasurisë së tyre të krijuar përpara emërimit në detyrën e magistratit, ndërkohë që i njëjti kontroll për ata parashikohet në çdo rast të zhvillimit të karrierës, që përfshinë edhe pasurinë e krijuar gjatë ushtrimit të detyrës, kontroll ky që zhvillohet pavarësisht kontrollit të deklarimeve periodike të pasurisë nga ILDKPKI-ja. Sa më lart, Këshilli vlerëson se një trajtim i diferencuar mes magistratëve në detyrë me ata të rekrutuar rishtazi cënon qëllimin e reformës në drejtësi, pra garantimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë. Dhe po ashtu, trajtimi i diferencuar i subjekteve të të njëjtës kategori, pa shkaqe të përligjura, në vlerësim të Këshillit mbart rrezikun e cënimit të pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, përgjegjësinë për sigurimin e të cilave Kushtetuta ia ka ngarkuar atij.

40.6 Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se standardi kushtetues i ligjshmësisë së pasurisë sipas pikës 3, neni D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndryshe nga sa kandidatja në rastin konkret pretendon, është i zbatueshëm edhe për kategorinë e kandidatëve për në formimin fillestar për magistratë në Shkollën e Magistraturës, sa kohë sipas ligjit rekrutimi i magistratëve vjen pikërisht nga të diplomuarit pranë kësaj Shkolle.

41. Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të bazuar kundërshtimin e kandidatës në lidhje me atë se, nuk përbën shkak ligjor për skualifikimin nga kandidimi, pra për mospranimin në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magistraturës, pasaktësia në deklaram dhe/ose mosjustifikimi i pasurisë së deklaruar nga bashkëshorti i kandidatit, si person i lidhur me të, që është krijuar përpara lidhjes së martesës dhe që zotërohet tërësisht nga personi i lidhur, përse kohë kjo pasuri nuk përdoret nga kandidati.

41.1 Në rastin në shqyrtim, problematika e konstatuar nga ILDKPKI-ja dhe mbi të cilat ajo ka arritur në konkluzionet e pasaktësisë në deklaram dhe mosjustifikimit të pasurisë, lidhet pikërisht me saktësinë e deklaramit të bashkëshortit të kandidatës sa i përket të ardhurave të tij nga paga, pranë Shoqërisë “Dola” sh.p.k, për periudhën Maj 2005 - Janar 2011, të cilat nuk përputhet me të ardhurat e deklaruara për të sipas dokumenteve zyrtarë, konkretisht sipas deklarimeve periodike mujore të subjektit tatimpagues (punëdhënësit) për efekte tatimore. Dhe po ashtu, kjo problematikë lidhet me krijimin, përmes këtyre të ardhurave, nga bashkëshorti i kandidatës, përpara lidhjes së martesës, të një pasurie të luajtshme, e cila sot ekziston në formën e likujditeteve gjendje në një depozite bankare, në pronësi dhe zotërim vetëm të tij.

41.2 Nga dokumentacioni i administruar, Këshilli vlerëson se nga verifikimi provohet se likujditetet në vlerën 12.708 euro, gjendje në depozitë bankare, në emër të bashkëshortit të kandidatës, përbën pasuri të luajtshme. Kjo pasuri është krijuar nga tjetërsimi në vitin 2017, prej bashkëshortit të kandidatës, të një pasurie apartament, në gjendje karabina, me vendodhje Kashar,

blerë nga ai në vitin 2011, pra disa vite përpara lidhjes së martesës mes tyre. Pra, likujditetet në depozitë bankare në këtë rast janë pasuri vetjake e bashkëshortit të kandidates, përsa kohë ajo është fituar nga tjetërsimi i një pasurie tjetër të fituar para lidhjes së martesës mes tyre, kundrejt së cilës bashkëshorti i kandidates ka qenë titullar i një të drejte reale përdorimi.

41.3 Konkretisht, rezulton se kandidatja dhe bashkëshorti i saj të kenë lidhur martesë ligjore më datë 25.02.2015 e për pasojë regjimi i tyre pasuror martesor rregullohet nga Kodi i Familjes në fuqi, miratuar me Ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003. Sipas nenit 66 të këtij Kodi, regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë. Në rastin konkret, përsa kohë nuk rezulton të ketë një marrëveshje të veçantë mes bashkëshortëve për të rregulluar, sipas vullnetit të tyre të lirë, regjimin pasuror martesor, atëherë regjimi pasuror martesor i tyre është ai i bashkësisë ligjore, referuar për ketë në nenin 73 të Kodit të Familjes.

41.4 Në nenin 74, Kodi i Familjes përcakton përbërjen e bashkësisë ligjore, në të cilën bëjnë pjesë: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës, ku në rastin kur veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit.

41.5 Ndërsa në nenin 77, Kodi i Familjes përcakton përbërjen e pasurisë vetjake të bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësinë ligjore. Konkretisht, sipas kësaj dispozite, *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi; b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë; c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesore të pasurisë vetjake; ç) mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare; d) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë; dh) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura; e) shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes”.*

41.6 Nën këtë parashikim ligjor, ligji (Kodi i Familjes) parashikon qartë se pasuria e krijuar para martese nga njëri bashkëshort dhe ajo e fituar nga tjetërsimi i një pasurie të tillë, është pasuri vetjake e bashkëshortit dhe nuk bën pjesë në bashkësinë ligjore, pra në pasurinë e përbashkët bashkëshortore.

Nisur nga kjo, pasuria vetjake është në pronësi vetëm të bashkëshortit që i përket, i cili e administron dhe përdor atë sipas dëshirës së tij.

41.7 Sa më sipër, pasuria apartament, në gjendje karabina, me vendodhje Kashar, e fituar nga bashkëshorti i kandidates përpara martesës me të, sipas Kontratës së Porosisë nr.797 rep. dhe nr.114 kol., datë 18.03.2011 dhe pagimit të çmimit të shitjes me pesë këste³, gjatë periudhës 17.03.2011 - 02.04.2013, ka qenë pasuri vetjake e tij. Nisur nga kjo, edhe pasuria në formë likuiditeti në vlerën 23.000 euro, fituar më datë 26.10.2017 nëpërmjet një transferte bankare në Intesa SanPaolo Bank, që përfaqëson çmimin e tjetërsimit të kësaj pasurie (apartamentit), sipas Kontratës së Cedimit (Transferimit) të Pronësisë nr.3069 rep. dhe nr.1989 kol., datë 25.10.2017, është gjithashtu pasuri vetjake e bashkëshortit të kandidates, pasuri e cila, në momentin e deklarimit, ka ekzistuar vetëm në vlerën 12.708 euro, gjendje në depozitë bankare në emër të tij.

41.8 Sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se çdo pasaktësi e mundshme në deklarimin e të ardhurave nga puna, për periudhën Maj 2005 - Janar 2011, nga bashkëshorti i kandidates, si dhe mosjustifikimi i mundshëm i pasurisë së luajtshme me burim origjinar krijimi nga këto të ardhura, që aktualisht ekziston në formë likuiditeti, gjendje në depozitë bankare në emër të bashkëshortit të saj, nuk mund të përbëjë shkak për skualifikimin e kandidates nga kandidimi për në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës. Është e qartë se veprimet e bashkëshortit të saj për krijimin e një pasurie përpara martesës nuk mund të afektojnë vlerat, standartet etike dhe sjelljen, në rastin konkret të një kandidate të mundshme për magjistrate.

42. Megjithatë, pavarësisht sa më lart, nga kontrolli pasuror i deklaratës së pasurisë së kandidates ka rezultuar se bashkëshorti i saj, pas datës 26.10.2017, pra mbas martesës së tyre, nga depozita e tij bankare në shumën 23.000 euro, ka bërë dy tërheqje, për një vlerë totale prej 10.292 euro. Nga kjo shumë rezulton se një pjesë e saj të jetë përdorur nga bashkëshorti i kandidates për nevojat e tija, ndërkohë që vlera 6.000 euro është përdorur për mobilimin e banesës bashkëshortore (blerjen e orendive të ndryshme shtëpiake), pra për fitimin, gjatë martesës, të një pasurie të luajtshme që, sipas ligjit, bën pjesë në bashkësinë ligjore të bashkëshortëve.

43. Pikërisht një rrethanë e tillë përbën shkak për të vënë në diskutim justifikimin të kësaj pasurie të luajtshme (orendive shtëpiake) pjesë e bashkësisë ligjore të bashkëshortëve, deklaruar me burim origjinar të krijimit të saj nga të ardhurat nga puna të bashkëshortit të kandidates, për periudhën Maj 2005 - Janar 2011.

44. Për këtë moment, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të pabazuara kundërshtimet e kandidates, duke vlerësuar se pasuria e luajtshme në fjalë nuk mund të klasifikohet si pasuri e ligjshme, duke

³ Mandat Arkëtimi nr.46, datë 17.03.2011, për shumën 15.570 euro; Mandat Arkëtimi nr.50, datë 07.07.2011, për shumën 2.837 euro; Mandat Arkëtimi nr.58, datë 14.11.2011, për shumën 2.860 euro; Mandat Arkëtimi nr.64, datë 06.04.2012, për shumën 3.430 euro dhe Mandat Arkëtimi nr.71, datë 02.04.2013, për shumën 653 euro.

dalluar në këtë rast ligjshmërinë e burimit të të ardhurave me ligjshmërinë e të ardhurave të magistratit, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë. Një burim të ardhurash mund të jetë i ligjshëm, por jo domosdoshmërisht të ardhurat e fituara nga ky burim konsiderohen të tilla, pasi për këtë ligji në çdo rast kërkon të jenë paguar detyrimet tatimore.

45. Rezulton se bashkëshorti i kandidates, ndër të tjera, ka qenë i punësuar pranë Shoqërisë “Dola” sh.p.k, për periudhën Maj 2005 - Janar 2011, marrëdhënie në kuadër të të cilës ai ka përfituar shpërblim, page. Në këtë rast burimi i këtyre të ardhurave, pra marrëdhënia e punës, është një burim i ligjshëm. Por se të ardhurat në këtë rast të bashkëshortit të kandidates jo të gjitha janë të ligjshme, pasi vërtetohet se vetëm për një pjesë të tyre, ato në vlerën 587.618 lekë, fituar gjatë periudhave Shtator 2005 - Shkurt 2007 dhe Qershor 2007 - Dhjetor 2007, janë paguar detyrimet tatimore, pikërisht tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Gjithsesi, në rastin konkret, e rëndësishme për çështjen, nuk janë tërësia e të ardhurave nga puna të bashkëshortit të kandidates për të gjithë periudhën e punës pranë Shoqërisë “Dola” sh.p.k, por vetëm ato sipas katër mandat pagesave⁴ të periudhës 17.03.2011 - 06.04.2012, për pagimin e pagave të prapambetura, në vlerën 3.460.000 lekë, të ardhura këto që, sipas mandate arkëtimeve të përmendura më lart, rezulton të kenë shërbyer tërësisht për krijimin nga ai, në vitin 2011, të pasurisë apartament, në gjendje karabina, me vendodhje Kashar, nga tjetërsimi i të cilës më pas, në vitin 2017, ka krijuar pasurinë e luajtshme në formë likuiditetesh në vlerën 23.000 euro, nga të cilat 12.708 euro janë gjendje në depozite bankare, ndërsa 6.000 euro janë përdorur për mobilimin e banesës bashkëshortore, blerjen e orendive shtëpiake pjesë e bashkësisë ligjore të bashkëshortëve. Për të ardhurat në vlerën 3.460.000 lekë, sipas katër mandat pagesave për pagimin e pagave të prapambetura nga Shoqëria “Dola” sh.p.k, nuk rezulton të jenë paguar detyrimet tatimore, pra tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ndërsa rezulton që bashkëshorti i kandidates të mos figurojë në formularët “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, dorëzuar në organet tatimore nga subjekti tatimpagues punëdhënës “Dola” sh.p.k, për periudhën Janar 2008 dhe në vazhdim, çka nënkupton se për bashkëshortin e kandidates nuk janë llogaritur, mbajtur dhe paguar detyrimet tatimore si i punësuar për periudhën përkatëse.

46. Është e vërtetë, sikurse parashtron dhe kandidatja, se sipas legjislacionit në fuqi, deklarimi i të punësuarit, llogaritja, mbajtja dhe pagimi i detyrimeve tatimore për të bëhet nga subjekti tatimpagues punëdhënës, por se një fakt i tillë nuk mund të zhbëjë faktin që për të ardhurat nga puna të bashkëshortit të kandidates, në vlerën 3.460.000 lekë, sipas katër mandat pagesave të periudhës 17.03.2011 - 06.04.2012, nuk janë paguar detyrimet tatimore.

⁴ Mandat Pagesë nr.57, datë 17.03.2011, për shumën 2.180.000 lekë; Mandat Pagesë nr.165, datë 07.07.2011, për shumën 400.000 lekë; Mandat Pagesë nr.273, datë 14.11.2011, për shumën 400.000 lekë dhe Mandat Pagesë nr.56, datë 06.04.2012, për shumën 480.000 lekë.

47. Po ashtu, Këshilli vlerëson se kandidatja dështon të provojë padijeninë e bashkëshortit të saj lidhur me mospërmbushjen nga punëdhënësi i tij “Dola” sh.p.k të detyrimeve ligjore sa i përket deklaramit të tij si të punësuar, llogaritjen, mbajtjen dhe pagimin e detyrimeve tatimore për të, sa kohë që lidhur me këtë nuk paraqet ndonjë akt provues për faktin e mbajtjes atij nga punëdhënësi të detyrimeve tatimore nga paga. Nga ana tjetër, fakti i pretenduar nga kandidatja vlerësohet i papranueshëm nga Këshilli sidomos për periudhën mbas datës 05.08.2007, kohë kur ka hyrë në fuqi Ligji nr.9766, datë 09.07.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, nëpërmjet të cilit, në pikën 1, të nenit 21 (titulluar “Shpenzimet e panjohura”), të ligjit bazë, është shtuar dhe shkronja “n”, duke patur tashmë kjo dispozitë këtë përmbajtje: *“1. Për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen shpenzimet si vijon: ...; n) shpenzimet për paga, shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar”*. Bazuar në këtë rregullim të ri ligjor, mbas datës 05.08.2007, për t’u njohur si të zbritshme për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, shpenzimet për pagat, shpërblimet dhe çdo formë tjetër të të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, punëdhënësit duhet t’ua paguanin ato të punësuarve nëpërmjet sistemit bankar. Sa kohë një gjë e tillë në rastin e bashkëshortit të kandidatës nuk ka ndodhur, pra ai nuk ka përfituar, nëpërmjet sistemit bankar, asnjë pagë, shpërblim apo çdo formë tjetër të të ardhurave personale, të lidhura me marrëdhënien e punësimit në Shoqërinë “Dola” sh.p.k, kandidatja nuk mund të pretendojë për padijeninë e bashkëshortit të saj rreth deklaramit të të ardhurave për të nga punëdhënësi “Dola” sh.p.k dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

48. Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se burimet financiare të bashkëshortit të kandidatës nuk justifikojnë krijimin, në vitin 2011, të pasurisë apartament, në gjendje karabina, me vendodhje Kashar, nga tjetërsimi i të cilës më pas, në vitin 2017, është krijuar pasuria e luajtshme në formë likuiditetesh në vlerën 23.000 euro, nga të cilat shuma 6.000 euro është përdorur për blerjen e orendive të ndryshme shtëpiake, pra për fitimin, gjatë martesës, të një pasurie të luajtshme që, sipas ligjit, bën pjesë në bashkësinë ligjore të bashkëshortëve, rrethanë vetëm kjo e fundit që afekton kandidaten në lidhje me verifikimin e kriterit të pasurisë.

49. Nisur nga sa më lart, duke mbajtur parasysh se burimi i krijimit të kësaj pasurie të luajtshme (orendi shtëpiake) pjesë e bashkësisë ligjore janë të ardhura të fituara nga tjetërsimi i një pasurie vetjake të bashkëshortit të kandidatës, pra të një pasurie të fituar nga ai para martesës mbi kursimet nga paga dhe për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në respektim të parimit të proporcionalitetit, një rrethanë e tillë në lidhje me ligjshmërinë e kësaj pasurie edhe të kandidatës, nuk mund të konsiderohet e atillë që të çojë në përfundimin për papranueshmërinë e ndjekjes nga ajo të programit të formimit fillestar për magistrat në Shkollën e Magistraturës, pra si shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi. Lidhur me parimin e proporcionalitetit, Këshilli mban në konsideratë se ky parim shërben për të peshuar dhe përcaktuar interesat dhe të drejtat e ndryshme konfliktuale në raste të ndryshme. Në kuadër të një procedure

administrative ky parim kushtetues merr një rëndësi thelbësore, duke qenë ai një nga parimet⁵ kryesore ku mbështetet organi administrativ në marrjen e vendimit. Në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron “ekuilibrimi i drejtë i interesave”, vlerësimi i rëndësisë dhe me objektivitet i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit nëse: (i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t’u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (*perifrazim nga çështjet Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 4 Dhjetor 2008, prg.101-104; Coster kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 18 Janar 2001, prg.106-108, 117-118; Faber kundër Hungarisë, vendim i datës 24 korrik 2012, prg. 28-41; Nada kundër Zvicrës, vendim i datës 12 Shtator 2012, prg.185 dhe 191*) (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 05.12.2012).

50. Në përfundim, bazuar në provat e administruara gjatë verifikimit, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe sipas bindjes së brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, si dhe atij të objektivitetit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja znj.{...} kalon kriterin e verifikimit të pasurisë.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit

51. Për kandidaten {...} u verifikua edhe kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin.

52. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

53. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare ose në aktivite të kundërligjshme.

⁵ Neni 12 i Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon se: “1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. 2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës; b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë”.

54. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkua dhe ajo plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 18.06.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

55. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 1782/223 prot., datë 02.09.2019, Vendimin “Për rezultatet e verifikimit”, sipas të cilit është vlerësuar se *“Subjekti deklarues {...} Bilbil{...}, kandidate për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

56. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 5655/1 prot., datë 19.08.2019, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidaten {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

57. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

58. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;

- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
 - ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtores ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
 - d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtores, informatores ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e saj për në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magistraturës.

III. KONKLUZIONE

59. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

60. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës, për vitin akademik 2019-2020.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2019-2020.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR